

## **NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE**

### **Arkivë**

Ne baze te ligjit te Agjencise te Trajtitimit te Kredive dhe rregullores se saj

### **Kërkesat e veçanta për perzgjedhjen e kandidatëve :**

- Të jetë shtetas shqiptar ;
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së presë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- të ketë kryer studimet e larta
- të ketë pervoje pune me shume se 1 vit ne administraten publike ose në sektorin privat / ose në shërbimin përmbartimor
- të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- zoterimi i nje gjuhe te huaj perben avantazh
- të ketë aftësi të mira drejtuese,menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup.

### **Përgjegjësitë**

Detyrat e Arkivistit:

- Mban në vend të sigurt në kasafortë të gjitha dosjet origjinale të debitorëve të transferuara nga ish bankat e nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror dhe INSIG sha.
- Evidenton, inventarizon dhe arkivon të gjitha dosjet e debitorëve që kanë mbyllur detyrimin. Dorëzimi i dosjes bëhet nga sekretari i Komisionit Teknik.
- Çdo konsultim apo verifikim dokumentacioni për dosjet e përshkruara në pikën 1 dhe 2, kryhet vetëm me autorizimin e Drejtorit të Përgjithshëm.
- Administron në dosjen e debitorit, të gjithë dokumentacionin dhe korrespondencën përkatëse që ka lidhje me të.
- Merr në dorëzim me procesverbal nga "Komisioni i Hartimit të Dokumentave" dokumentat e tenderit, pasi kanë përfunduar procedurat. Marrja e tyre për verifikim, studim ose për çfaredo arsye tjetër bëhet me urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm.
- Mban përgjegjësi ligjore deri penale për humbjen e dokumentave të ndodhura në Arkivë.

## **Procedurat e Përgjithshme të Aplikimit :**

Aplikimi duhet të përmbajë:

- Kërkesë me shkrim
- Curriculum vitae
- Libreza e punes
- Dëshmi Penaliteti

Aplikimet duhet të dërgohen në zarf të mbyllur duke specifikuar pozicionin në adresën:

**Agjensia e Tratjimit të Kredive**

**Njësia Administrative nr.5, Tiranë Rruga “Dora D’Istria”, Ndërtesa 22 Hyrja 1. Kodi 3771821017**

### **Afati**

Aplikimet pranohen deri në datë 21 Janar 2022 ora 12:00. Do të shqyrtohen vetëm ato aplikime që mbërrijnë brenda këtij afati. Pas vlerësimit të dokumentave vetëm kandidatët e suksesshëm do të ftohen për intervistë.